



Nëse e ke herët për pension,
nuk e ke herët për penzija.mk



Nëntor, 2020



SAVA
PENZISKO



triglav

Триглав пензиско друштво

STRUKTURA E SISTEMIT TË PENSIONIT NË RMV



Sistemi i maqedonisë i pensioneve është pjesë e sigurimeve shoqërore të Republikës së Maqedonisë së Veriut (RMV) dhe ka strukturën si në vijim:

1

Sigurimi në bazë të solidaritetit të gjeneratave (e ashtuquajtura shtylla e parë),

Shtylla e parë financohet në mënyrë të vazhdueshme (PAYG), që do të thotë se me kontributet nga të siguruarit ekzistues, paguhen pensionet e pensionistëve aktualë.

2

Sigurimi i detyrueshëm kapitale financiare pensionale (i ashtuquajhuri shtylla e dytë),

Ky lloj i sigurimit të pensionit, është i bazuar në parimin e mbledhjes së fondeve duke paguar kontribute në llogari individuale mjetet e të cilave investohen më tej dhe fitimi i zvogëluar nga kostot operative të sistemit shtohet (akumulohet) në fondet e llogarive individuale.

3

Sigurimi i pensionit vullnetar i financiar plotësisht (i ashtuquajhuri shtylla e tretë).

Ky sigurim pensioni është gjithashtu sigurim i bazuar në kapitalizimin e mjeteve, mbi parimin e kontributeve të përcaktuara, por mbi bazë vullnetare. E rëndësishme për këtë sigurim pensioni është që mund të përfshijë të gjithë personat që duan të sigurojnë një përfshirrje më të lartë të sigurisë materiale përveç sigurimit të detyrueshëm, si dhe të gjithë personat që nuk janë të mbuluar nga sigurimi i detyrueshëm (në shtyllën e parë dhe të dytë).

2

SHTYLLA E DYTË- ANËTAR I DETYRUESHËM I FONDIT TË PENSIONIT MUND TË JENI:



Nëse për të parën herë jeni duke hyrë në sigurimin e detyrueshëm të pensionit dhe aftësisë së kufizuar pas 1 janarit 2019 dhe në datën e pranimi ju jeni në moshën nën 40 vjeç.

SI TË BËHENI ANËTAR I FONDIT TË DETYRUESHËM TË PENSIONIT ?



Ju mund të bëheni anëtar i një fondi të detyrueshëm pensioni në dy mënyra:




Me nënshkrimin e një marrëveshje për anëtarësim në një fond të detyrueshëm pensioni dhe me regjistrim në Regjistrin e anëtarëve të evidentuar nga Agjencia ose



Me shpërndarje në një fond pensioni të detyrueshëm me përzgjedhje të rastësishme dhe me regjistrim në Regjistrin e anëtarëve të mbajtur nga Agjencia, nëse brenda 3 muajve nga punësimi juaj i parë nuk nënshkruani një marrëveshje me ndonjë kompani pensioni.

PAGESA E KONTRIBUTEVE NGA RROGA BRUTO NE SHTZLLËN E PARË TË FONDIT TË PENSIONIT



Shuma e kontributit, e cila transferohet në fondin e pensionit të detyrueshëm në llogarinë tuaj individuale, është 6% e pagës tuaj bruto, dhe në PDIF mbetet një kontribut në shumën që merret si diferencë midis kontributit total për pensionin dhe sigurimin e aftësisë së kufizuar dhe kontributit të paguar në shtyllën e dytë (për vitin 2020 është 12.8% e pagës bruto (12.8% = 18.8% -6%)).

KENI TË DREJTËN TË ZGJEDHNI FONDIN E PENSIONIT TË DETYRUESHËM

Ju si punonjës keni të drejtën e zgjedhjes personale, brenda tre muajve nga punësimi juaj i parë, me cilën kompani pensioni do të lidhni një marrëveshje për anëtarësim në një fond të detyrueshëm pensioni.

Tani ekzistojnë tre ndërmarrje pensioni që administrojnë një fond pensioni të detyrueshëm dhe një fond pensioni vullnetar:



KB SHOQATA E PARË PENSIONALE AD Shkup
rr. Mitropoliti Theodosij Gologanov nr. 6 Shkup
tel. 02-3243-777, www.kbprvo.mk



SHOQATA PENSIONALE SAVA a.d. Shkupi
rr. Nënë Tereza Nr. 1 Shkup,
tel. 02-15-500, www.sava-penzisko.mk



SHOQATA PENSIONALE TRIGLAV AD Shkup
bul 8 Shtatori nr. 16 Shkup,
tel. 02-5102-190, www.triglavpenzisko.mk

3

SHTYLLA E TRETË - Keni të drejtë të përfshiheni në sigurimin e finansimit kapital të pensionit vullnetar.


Ju keni të drejtë të bëheni anëtar i një sigurimi pensional të financuar kapital vullnetarisht:


Nëse jeni nga 15 vjeç, por jo më shumë se 70 vjeç

dhe / ose

Nëse punëdhënësi ose shoqata juaj ju përfshin në një skemë pensioni profesional

* Pensionist nuk mund të jetë anëtar i shtyllës së tretë.





SI TË BËHENI ANËTAR I FONDIT TË PENSIONIT VULLNETAR?

Ekzistojnë tre mënyra se si mund të bëheni anëtar i një fondi pensioni vullnetar:



Duke nënshkruar një marrëveshje për anëtarësim në një fond pensioni vullnetar me kompaninë dhe duke hapur një llogari individuale vullnetare.



Duke nënshkruar një marrëveshje për anëtarësim në një fond vullnetar pensioni që do të jetë midis jush, paguesit dhe kompanisë dhe duke hapur një llogari individuale vullnetare.



Duke marrë pjesë në një skemë pensioni profesional, të organizuar nga punëdhënësi ose shoqata juaj, dhe duke hapur një llogari profesioni.

SI PAGUHEN MJETE NË SHTYLLËN E TRETË?

Ti si anëtar mund të paguajsh:



kontribut vullnetar për veten,



në emrin tënd dhe në xhirrologarinë tënde person i tretë të paguan kontribut vullnetar (i ashtuquajtur i pagues) ose




ju të paguheni nga punëdhënësi ose financues i një skeme pensioni profesional.



NË CILAT INSTRUMENTE FINANCIARE SHOQATA E PENSIONIT INVESTON PARATË TUAJA?

Shoqata juaj e pensioneve mjetet e fondeve te pensionit me shpesh i investon në: depozitat bankare, aksionet nga emetuesit vendas, obligacionet nga emetuesit vendas, letrat me vlerë afatshkurtra nga emetuesit vendas, aksionet nga emetuesit e huaj, fondet e investimeve nga emetuesit e huaj, etj.



Fotografia 1: Struktura e investimit ne fondin e pensionit

TRANSFERIMI NË FOND TJETËR TË PENSIONIT

Një e drejtë e rëndësishme për të gjithë anëtarët e një sistemi të financuar kapital të sigurimit të pensioneve është barrtja e fondeve. Si anëtar i një fondi pensioni të detyrueshëm ose vullnetar, ju keni të drejtën e zgjedhjes dhe të drejtën për të ndryshuar fondin e zgjedhur të pensionit, sipas gjykimit tuaj, në çdo kohë.

Kur ndryshoni fondin e pensionit, fondet tuaja të kursyera transferohen poashtu. Gjithashtu në rast të pjesëmarrjes në një skemë pensioni profesional, ju keni të drejtë, kur barrteni te një tjetër sigurues, të transferoni fondet e kursyera ose në një skemë tjetër pensioni profesional ose në llogarinë tuaj individuale vullnetare.



KORRIGJONI TË DHËNAT TUAJA PERSONALE

Në mënyrë që të merrni raportin e rregullt vjetor, të njohur si zarfi jeshil, me saktësi dhe në kohën e duhur, **korrigjoni informacionin tuaj personal.** Ju mund ta bëni korrigjimin në një nga mënyrat e mëposhtme:



Korrigjimi me një kërkesë me shkrim

– plotësoni një Kërkesë për integrim/ korrigjim të të dhënave personale. Për më tepër, për identifikimin tuaj, kompania do të inspektojë identifikimin tuaj personal përmes një personi ose agjenti të autorizuar dhe gjithashtu do t'ju kontaktojë me telefon.



Korrigjimi përmes faqes së internetit

– kompania juaj e pensioneve, përmes sistemit të saj elektronik në faqen e internetit, ju lejon të korrigjoni informacionin tuaj personal: emrin, mbiemrin, adresën e vendbanimit, vendbanimin, kodin postar, vendin e korrespondencës, kodin postar të korrespondencës , adresa e korrespondencës, telefoni dhe posta elektronike.



Korrigjimi përmes kontaktit telefonik me kompanitë e pensioneve

– mund të azhurnoni dhe / ose korrigjoni të dhënat në lidhje me adresën tuaj të banimit ose adresën e korrespondencës duke telefonuar në numrat e telefonit të kontaktit të kompanisë suaj të pensioneve.

ÇFARË PËRMBAN ZARFJA E GJELBËR ?



Ekzistojnë dy lloje raportesh në zarfin e gjelbër:

- 1** Raporti i parë përmban informacion mbi gjendjen e fondeve në llogarinë individuale të kursimeve të pensionit.
- 2** Raporti i dytë përmban informacion se ku investohen mjetet e fondit të pensionit së bashku me të dhëna të hollësishme mbi përfitimet e mbledhura dhe kthimin e realizuar të fondit të pensionit.

Kompania juaj e pensioneve dorëzon një zarf të gjelbër me një njoftim vjetor për vitin paraprak, jo më vonë se 31 Mars të vitit aktual.

Keni mundësinë që në mënyrë të shpejtë dhe të simplifikuar të merrni raportet mbi kursimet e pensioneve përmes postës elektronike.

A MUNDET TË VAZHDIMËSI TË NDIQET GJENDJA E LLOGARISË INDIVIDUALE ?

Si anëtar i një fondi pensioni, ju keni mundësinë të kontrolloni shpejt, lehtë dhe në një mënyrë moderne gjendjen e llogarive tuaja individuale në çdo kohë, on-line në faqen e internetit të kompanisë së pensioneve.



A JANË TË SIGURTA MJETET NE SHTYLLEN E DYTË DHE TË TRETË



Ekzistojnë rregulla strikte për investimin e mjeteve të fondeve pensionale, të vërtetuara me ligj, të cilat sigurojnë shpërndarjen e mjeteve që mbrojnë nga rënia e mundshme e vlerës së tyre. MAPAS mbikëqyr punën e ndërmarrjeve çdo ditë në mënyrë që të sigurojë që kompanitë të ndjekin këto rregulla. Pasuritë tuaja si pjesë e fondit të pensioneve janë plotësisht të ndara nga pasuritë e shoqërisë pensionale, ruhen në bankë - kujdestari i pasurisë dhe janë të destinuara për pagimin e pensionit.



Misioni i MAPAS-it është të mbrojë interesat e anëtarëve dhe anëtarëve të pensionuar të fondeve të pensionit dhe të inkurajojë zhvillimin e sigurimeve të pensioneve të financuara plotësisht për ditë më të sigurta pensioniste

FAKTE INTERESANTE - SHTYLLA E DYTË

Shtylla e Dytë

2

- » Nëse e humbni punën tuaj Ju nuk e humbni të drejtën e anëtarësimit në shtyllën e dytë, fondet tuaja janë ende të investuara dhe me ri-punësimin pagesa e kontributeve vazhdon në të njëjtën llogari individuale në fondin e pensionit ku keni qenë anëtar më parë.
- » Fondet nga shtylla e dytë mund të përdoren kur ju ushtroni të drejtën për pension pleqërie, dmth 64 vjeç për burrat dhe 62 vjeç për gratë dhe minimumi 15 vjet përvojë pune.
- » Mjetet e shtylles së dytë i nënshtrohen trashëgimisë.

Shtylla e Tretë

3

- » Kompania hap një llogari individuale vullnetare ose llogari profesionale për ju si një anëtar, menjëherë pas pagesës së parë të kontributit.
- » Ti, si anëtar, paguesi dhe siguruesi, keni të drejtë të përcaktoni lirisht shumën e kontributeve vullnetare të paguara, si dhe dinamikën e pagesës. Ndryshimi i shumës së pagesës ose ndërprerja e pagesës, nuk ndikojnë në të drejtën e anëtarësimit tuaj në fondin e pensionit vullnetar, dmth nuk nënkuptojnë përfundimin e anëtarësisë.
- » Dhjetë vjet para moshës për fitimin e së drejtës për pension pleqërie, që për momentin do të nënkuptojë moshën më të hershme në moshën 54 vjeç për burrat, përkatësisht 52 për gratë. Në rast të paafësisë së përgjithshme për punë, fondet mund të tërhiqen pavarësisht nga mosha.
- » Nëse ti, si anëtar i një fondi pensioni vullnetar, ndërpret pagesën e kontributeve në fondin e pensionit vullnetar përpara daljes në pension, ju do të qëndroni anëtar i fondit të pensionit vullnetar deri në momentin e ushtrimit të së drejtës për kompensim pensioni, deri në transferimin në një fond tjetër pensioni vullnetar ose deri në vdekje, dhe do të keni të njëjtat të drejta si anëtarët e tjerë të fondit të pensionit vullnetar.



**Koha deri në pension kalon më shpejt sesa
mund ta paramendosh.**